Buletin informativ
Shkolla e Magjistraturës

tetor 2026
Nr. 7

## Përmbajtja

**1:** Veprimtari kryesore

**2:** Formimi Fillestar

**3:** Formimi Vazhdues

**4:** Platforma digjitale dhe shërbime online

**5:** Botime

## Hyrje

Të nderuar,

Me kënaqësi sjellim për ju botimin e radhës të Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës, një platformë komunikimi institucionale që pasqyron veprimtarinë, arritjet dhe zhvillimet më të rëndësishme të Shkollës.
Ky numër publikohet në fillim të vitit të ri akademik, një moment i veçantë që shënon vazhdimësinë e misionit tonë për formimin profesional dhe zhvillimin e brezave të rinj të profesionistëve të drejtësisë.
Ai ofron një pasqyrë të aktiviteteve akademike, trajnimeve, bashkëpunimeve institucionale dhe nismave që kontribuojnë në forcimin e cilësisë së programeve të formimit fillestar dhe të vazhdueshëm.
Përmes këtij buletini synojmë të pasqyrojmë veprimtarinë tonë, duke promovuar transparencën, shkëmbimin e përvojave dhe dialogun institucional. Njëkohësisht, ai dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të Shkollës së Magjistraturës ndaj përsosmërisë në arsimimin juridik dhe forcimit të standardeve profesionale në sistemin e drejtësisë.

Ju ftojmë të ndiqni në faqet në vijim aktivitetet dhe zhvillimet që kanë shoqëruar këtë periudhë të rëndësishme për institucionin tonë dhe stafin e tij akademik.

## 1. Veprimtari kryesore

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e Shkollës kanë zënë aktivitetet trajnuese të fokusuara në zhvillimet më të fundit të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore, përfshirë çështje të së drejtës penale, civile dhe administrative, të drejtës evropiane, të drejtave të njeriut, drejtësisë digjitale, hetimit të krimeve komplekse dhe përdorimit të teknologjisë në sistemin e drejtësisë.
Paralelisht, Shkolla ka organizuar konferenca, forume diskutimi, tryeza shkencore dhe aktivitete ndërinstitucionale, duke krijuar hapësira për shkëmbimin e praktikave më të mira profesionale dhe forcimin e dialogut mes institucioneve të drejtësisë, akademisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së saj ka qenë bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizimi i vizitave studimore dhe programeve të trajnimit në nivel evropian, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së formimit profesional.
Fillimi i vitit të ri akademik 2026-2027 shënon gjithashtu vijimin e misionit të Shkollës në përgatitjen e brezave të rinj të profesionistëve të drejtësisë, me programe të përditësuara mësimore, aktivitete orientuese për kandidatët dhe një fokus të shtuar në zhvillimin e kompetencave profesionale, digjitale dhe etike.

Kjo veprimtari e larmishme pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të Shkollës së Magjistraturës për të kontribuar në forcimin e profesionalizmit, integritetit dhe eficiencës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

***Formim i vazhdueshëm, transparencë institucionale dhe përsosmëri profesionale***

***në shërbim të drejtësisë.***

# Formimi Fillestar

## Ceremonia e çeljes së vitit akademik 2026-2027

Më 5 tetor 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi ceremoninë e hapjes së vitit akademik 2026-2027, në prani të përfaqësuesve të institucioneve më të larta të sistemit të drejtësisë, partnerëve ndërkombëtarë, pedagogëve dhe kandidatëve për magjistratë.

Ceremonia u çel nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi, ndërsa të pranishmit u përshëndetën edhe nga Presidenti i Republikës, shkëlqesia e tij, z. Bajram Begaj, Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, z. Sokol Sadushi, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, Kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Mirela Bogdani, zëvendësprokurori i Prokurorisë së Përgjithshme z. Arqilea Koça, Ministri i Drejtësisë, z. Toni Gogu, Ambasadorja e Bashkimit Evropian, znj. Sofia Moreira de Sousa, Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Michel Tarran, si dhe Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, znj. Giulia Re.
Në kuadër të aktivitetit u shfaq filmi dokumentar “Magjistratura në 3D”, i cili pasqyron zhvillimin dhe rolin e Shkollës së Magjistraturës në formimin e brezave të rinj të profesionistëve të drejtësisë.





Një moment i veçantë i ceremonisë ishte betimi i kandidatëve për magjistratë, avokat shteti dhe ndihmës ligjor, të cilët nisin rrugëtimin e tyre profesional në shërbim të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës.

Ceremonia u mbyll me fotografinë e përbashkët të pjesëmarrësve, duke shënuar nisjen zyrtare të një viti të ri akademik, të fokusuar në përgatitjen cilësore të magjistratëve të ardhshëm dhe në forcimin e mëtejshëm të institucioneve të drejtësisë.



## Hyrje në Programin e Formimit Fillestar

Në prag të fillimit të vitit të ri akademik, Shkolla e Magjistraturës organizoi në Voskopojë, më 1-3 tetor, një aktivitet orientues për kandidatët për magjistratë dhe avokatë shteti. Përmes sesioneve informuese dhe ushtrimeve praktike, kandidatët u njohën me programin e formimit fillestar, standardet etike, platformën digjitale të mësimdhënies, si dhe me përdorimet dhe sfidat etike të inteligjencës artificiale, duke krijuar njëkohësisht baza të forta bashkëpunimi me njëri-tjetrin dhe stafin e Shkollës.



***Në fokus: Digjitalizimi i proceseve akademike përmes përdorimit të platformës SMVSHM dhe Microsoft Teams, me qëllim lehtësimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe dokumentimit të veprimtarisë mësimore.***

## Aktivitetet e muajit

- 1-3 tetor u zhvillua aktiviteti trajnues me kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti për njohjen e Programit të Formimit Fillestar.
- 5 tetor – nisja e vitit të ri akademik 2026-2027.
- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- Fillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti të vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata dhe prokurori.
- Zhvillimi i vlerësimit të parë dhe të dytë në lëndën e gjykimit kushtetues me kandidatët për magjistratë dhe vlerësimit 1 në të drejtën evropiane me kandidatët për ndihmës ligjor.
- Zhvillimi i vlerësimit në kursin e anglishtes ligjore për kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti të vitit të dytë.

## Takim me kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor të brezit 2025-2026

Kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë të brezit 2025–2026 u mirëpritën në mjediset e Shkollës së Magjistraturës, nga Drejtori i Shkollës.

Gjatë takimit, kandidatëve iu shpërndanë diplomat që certifikojnë përfundimin me sukses të programit. Ata ndanë kujtime dhe reflektime nga periudha e formimit në Shkollën e Magjistraturës, duke rikujtuar përvojën e fituar dhe sfidat e përballuara përgjatë këtij rrugëtimi.

Ky çast shënoi përmbylljen e një etape të rëndësishme të përgatitjes së tyre profesionale dhe njëkohësisht fillimin e angazhimit të tyre në mbështetje të funksionimit dhe forcimit të sistemit të drejtësisë.



## Viti i parë

Gjatë këtij viti, Shkolla do të ushtrojë veprimtarinë e saj të formimit fillestar profesional për të tre vitet e programit.

Për herë të parë, kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për avokat shteti, gjatë vitit të parë të studimeve, do të ndjekin një program të veçantë dhe të pavarur nga ai i kandidatëve për ndihmës ligjor. Gjithashtu, në vitin e dytë të studimeve kemi edhe brezin e parë të kandidatëve për avokat shteti, duke shënuar një etapë të rëndësishme në konsolidimin e këtij profili profesional në kuadër të formimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

Ky organizim i ri pasqyron zhvillimin dhe zgjerimin e rolit të Shkollës së Magjistraturës në përgatitjen profesionale të magjistratëve, avokatëve të shtetit dhe ndihmësve ligjorë, në përputhje me nevojat e sistemit të drejtësisë.





Gjatë muajit tetor kandidatët për magjistratë dhe kandidatët për ndihmës ligjor iu nënshtruan vlerësimeve të para në lëndën e gjykimit kushtetues dhe drejtësisë evropiane.

***Vlerësimi nuk është fundi i të mësuarit, por një hap drejt përmirësimit.***

## Prezantimi i kursit HELP "E drejta për liri dhe siguri"

Kandidatët për magjistratë të vitit të parë morën pjesë në takimin prezantues të kursit **"E Drejta për Liri dhe Siguri"**, i organizuar në bashkëpunim me Programin HELP (Human Rights Education for Legal Professionals) të **Këshillit të Evropës**. Kursi është përshtatur për kontekstin shqiptar nga prokurori Florian Boriçi.

Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Shkollës së Magjistraturës, si dhe online nëpërmjet platformës Zoom, duke u ofruar kandidatëve mundësinë të njihen me standardet evropiane dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e së drejtës për liri dhe siguri.

Takimi u hap me fjalët përshëndetëse të z. Arben Rakipi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, dhe znj. Ana-Maria Telbis, Drejtuese e Programit HELP në Këshillin e Evropës. Më tej, znj. Dorina Ndreka, juriste pranë Regjistrit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, prezantoi për kandidatët jurisprudencën e Gjykatës lidhur me të drejtën për liri dhe siguri.

Gjatë sesionit, kandidatët u njohën me strukturën e kursit, objektivat mësimore, kriteret e vlerësimit, përshtatjen e programit me sistemin ligjor shqiptar, si dhe me aspektet praktike të ndjekjes së kursit dhe regjistrimit në platformën HELP të Këshillit të Evropës. Ky prezantim u zhvillua nga znj. Ana-Maria Telbis dhe z. Florian Boriçi, prokuror pranë Prokurorisë së Tiranës.

Pjesëmarrja në këtë kurs përbën një mundësi të rëndësishme për kandidatët e vitit të parë për të thelluar njohuritë e tyre mbi standardet evropiane të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e tyre në praktikë.






## Viti i dytë

Viti i dytë akademik shënon një etapë të rëndësishme në formimin profesional të kandidatëve për magjistratë dhe avokatë të shtetit. Krahas thellimit të njohurive teorike përmes zhvillimit të mësimit në auditor, kandidatët angazhohen edhe në praktikën paraprofesionale pranë gjykatave dhe prokurorive, duke u njohur nga afër me funksionimin e institucioneve të drejtësisë dhe sfidat e ushtrimit të profesionit.

Ky kombinim i formimit akademik dhe përvojës praktike synon të forcojë aftësitë profesionale, etike dhe analitike të kandidatëve, duke krijuar ura të qëndrueshme midis njohurive teorike dhe zbatimit të tyre në praktikë. Përmes kësaj përvoje, kandidatët zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të ushtruar me integritet, profesionalizëm dhe përgjegjësi funksionet e tyre të ardhshme në sistemin e drejtësisë.



## Viti i tretë

Kandidatët e vitit të tretë vazhdojnë praktikën profesionale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (dhoma civile dhe penale), si dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudhën e parë, ku po njihen nga afër me funksionimin praktik të institucioneve të drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe, ata janë përfshirë në ndjekjen e çështjeve gjyqësore dhe procedurave hetimore, duke përfituar njohuri konkrete mbi zbatimin e legjislacionit material dhe procedural. Njëkohësisht, kandidatët po japin kontributin e tyre në punën e përditshme të këtyre institucioneve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve përkatës, duke zhvilluar aftësi profesionale, etike dhe praktike të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve në sistemin e drejtësisë.

***Viti i tretë përfaqëson etapën kulmore të formimit fillestar, ku kandidatët për magjistratë ndërthurin njohuritë teorike me përvojën praktike, duke u përgatitur për të marrë përgjegjësitë e funksionit të tyre në shërbim të drejtësisë.***

## Orari për muajin nëntor

### Kandidatët për magjistratë dhe avokat shteti

| MUAJI NËNTOR 2026 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Orari | E hënë 2 | E martë 3 | E mërkurë 4 | E enjte 5 | E premte 6 | E shtunë 7 | E diel 8 |
| Java 5 | Etikë 8 | Gj. Civil 6 | Gjykim penal 6 | Gj. Administrativ6 | Etikë 4 | | |
| | | | | | Gj. Kushtetues 4 | | |
| Orari | E hënë 9 | E martë 10 | E mërkurë 11 | E enjte 12 | E premte 13 | E shtunë 14 | E diel 15 |
| Java 6 | Etikë 4 Vlerësimi 1 (1 orë) | Gj. Civil 7 | Gjykim penal 6 | Gj. administrativ Vlerësimi 1 | Etikë 4 | | |
| | Gj. kushtetues 4 | | | | Gj. Kushtetues 4 | | |
| Orari | E hënë 16 | E martë 17 | E mërkurë 18 | E enjte 19 | E premte 20 | E shtunë 21 | E diel 22 |
| Java 7 | Etikë 4 | Gj. Civil 6 Vlerësimi 1 | Gjykim penal 6 | Gj. administrativ 6 orë | Etikë 8 | | |
| | Gj. Kushtetues 4 | | | | | | |
| Orari | E hënë 23 | E martë 24 | E mërkurë 25 | E enjte 26 | E premte 27 | E shtunë 28 | E diel 29 |
| Java 8 | | Gj. Civil 7 | Gjykim penal 6 | Gj. administrativ 8 | Gj. Kushtetues | | |
| | | | | | Vlerësimi 3 | | |
| Orari | E hënë 30 | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

### Kandidatët për ndihmës ligjor

| MUAJI NËNTOR | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Orari | E hënë 2 | | E martë 3 | | E mërkurë 4 | | E enjte 5 | | E premte 6 | | E shtunë 7 | E diel 8 |
| Java 5 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | | |
| | Gj.civil6 | MAD8 | MAD | DE7 | DE7 | Gj.civil7 | ASHL | Psikologji | I mituri | ASHL | | |
| | | | | | | | Psikologji | I mituri | | | | |
| Orari | E hënë 9 | | E martë 10 | | E mërkurë 11 | | E enjte 12 | | E premte 13 | | E shtunë 14 | E diel 15 |
| Java 6 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | | |
| | Gj.civil6 | DE5 | Vlerësim | MAD | DE5 | Gj.civil6 | ASHL | Psikologji | Vlerësimi | | | |
| | | | FUND | | | | Psikologji | ASHL | I mituri | FUND | | |
| | | | | | | | | | | | | |
| Orari | E hënë 16 | | E martë 17 | | E mërkurë 18 | | E enjte 19 | | E premte 20 | | E shtunë 21 | E diel 22 |
| Java 7 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | | |
| | Gj.civil7 | Praktikë1 | DE | | Praktikë1 | Gj.civil7 | Psikologji | Fund | Puna4 | ASHL4 | | |
| | | | Vlerësimi | 2 | | | ASHL | Puna4 | | | | |
| Orari | E hënë 23 | | E martë 24 | | E mërkurë 25 | | E enjte 26 | | E premte 27 | | E shtunë 28 | E diel 29 |
| Java 8 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | Klasa 1 | Klasa 2 | | |
| | | | Praktikë2 | DE6 | DE6 | Praktikë2 | ASHL4 | Puna8 | Puna8 | ASHL 4 | | |
| | | | | | | | GJF4 | | | GJF4 | | |
| Orari | E hënë 30 | | | | | | | | | | | |
| Java 9 | Klasa 1 | Klasa 2 | | | | | | | | | | |

***Çdo brez i ri profesionistësh të drejtësisë është një investim në forcimin e shtetit të së drejtës dhe të besimit të qytetarëve te institucionet.***

## Formimi vazhdues

Në datë 1 shtator 2026, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi Kalendarin e Aktiviteteve Trajnuese të Programit të Formimit Vazhdues për vitin akademik 2026-2027, i cili reflekton prioritetet e identifikuara nga analiza e nevojave për trajnim, si dhe një qasje më të strukturuar në planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve. Një risi e këtij viti është përfshirja më e konsoliduar e koordinatorëve të moduleve, të cilët, në bashkëpunim me Shkollën, do të kenë një rol aktiv në hartimin, koordinimin, ndjekjen dhe vlerësimin e veprimtarive trajnuese, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së Programit.

Gjatë muajit tetor 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 22 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 486 pjesëmarrës (numër total pjesëmarrësish).

**1. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe metodologjike të trajnerëve dhe mentorëve.**

Kalendari i ri i trajnimeve u çel me një sërë aktivitetesh për trajnimin e trajnerëve (Training of Trainers – ToT), në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe metodologjike të ekspertëve të angazhuar në procesin e formimit vazhdues.

Në këtë kuadër, në datat 16–17 dhe 21–22 shtator 2026, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me organizatën Civil Rights Defenders, organizoi dy trajnime për trajnerë (ToT), në kuadër të projektit “Forcimi i bashkëpunimit rajonal gjyqësor në Ballkanin Perëndimor për procese gjyqësore efektive para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian”.



**Foto. Trajnim Trajnerësh mbi fushën e të Drejtës së BE-së**

Më 15 tetor 2026, Shkolla e Magjistraturës organizoi trajnimin për trajnerë me temë “Metodologjia e zhvillimit të aktiviteteve trajnuese”, me fokus përmirësimin e aftësive metodologjike dhe përdorimin e qasjeve bashkëkohore në hartimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese.



**Foto. Trajnim Trajnerësh, datë 15 tetor 2026**

Ndërsa, më 16 tetor 2026, u zhvillua trajnimi për mentorët mbi Programin e Mentorimit për kandidatët magjistratë, ku u trajtuan aspektet kryesore të procesit të mentorimit, roli i mentorit

dhe përgjegjësitë në mbështetjen e zhvillimit profesional të kandidatëve gjatë formimit praktik.



**Foto. Trajnim i mentorëve, datë 16 tetor 2026**

Në datat 19, 27 dhe 28 tetor 2026, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me IRZ organizoi një trajnim treditor për mentorët e kandidatëve magjistratë të vitit të tretë, me temë "Menaxhimi efektiv i çështjeve dhe roli aktiv i gjyqtarit".

Trajnimi kishte në fokus njohjen dhe zbatimin e Udhëzuesit për Menaxhimin Efektiv të Çështjeve dhe Rolin Aktiv të Gjyqtarit, si dhe forcimin e aftësive pedagogjike të mentorëve për përcjelljen e këtyre standardeve te kandidatët magjistratë gjatë praktikës profesionale. Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të mentorëve në integrimin e parimeve të menaxhimit efektiv të çështjeve në praktikën e përditshme gjyqësore, përmes udhëzimit, demonstrimit dhe mbështetjes së kandidatëve në formimin e shprehive të tyre profesionale.



**Foto. Trajnimi 3-ditor, datë 19, 27-28 tetor 2026.**

**2. Etika, integriteti dhe komunikimi në ushtrimin e funksionit të magjistratit**

Në kuadër të modulit "Çështje të etikës, integritetit, deontologjisë dhe komunikimit", gjatë muajit tetor u zhvillua një cikël trajnimesh, për grupin e parë të kandidatëve për magjistratë të vitit të tretë të formimit fillestar, që trajtoi disa prej dimensioneve thelbësore të ushtrimit të funksionit të magjistratit. Temat përfshinë inteligjencën emocionale dhe menaxhimin e stresit në punën e magjistratit, komunikimin institucional, paanshmërinë si standard kushtetues dhe ligjor, integritetin si vlerë etike dhe profesionale, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik.

Një pjesë e këtij cikli u organizua në bashkëpunim me Institutin Evropian të Administratës Publike (EIPA), duke sjellë një dimension shtesë në trajtimin e tematikave dhe shkëmbimin e përvojave profesionale.




**Foto. Trajnim në bashkëpunim me EIPA, datë 20-21 tetor 2026**

**3. Zhvillimi i kapaciteteve në fushën e hetimit dhe policisë gjyqësore**

Në datat 13, 14 dhe 20 tetor 2026, në kuadër të modulit "Policia Gjyqësore", u zhvillua një cikël trajnimesh i fokusuar në sfidat bashkëkohore të hetimit penal, përdorimin e inteligjencës dhe teknologjisë në procesin hetimor, si dhe administrimin dhe vlerësimin e provave.

Trajnimet trajtuan çështje të tilla si hetimi i drejtuar nga inteligjenca, ndërtimi i strategjisë hetimore dhe i teorisë së çështjes, hetimi financiar, provat dixhitale, forenzika, përdorimi i burimeve të hapura të informacionit (OSINT), dokumentimi dixhital dhe inteligjenca artificiale në hetim. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe bashkëpunimit ndërmjet policisë gjyqësore dhe prokurorit, si dhe bashkëpunimit me agjencitë ndërkombëtare.




**Foto. Trajnim, datë 13 tetor 2026**




**Foto. Trajnim, datë 20 tetor 2026**

**4. Pronësia dhe problematikat aktuale të së drejtës së pronës**

Gjatë muajit tetor, në kuadër të modulit “Pronësia”, u zhvillua një cikël aktivitetesh trajnuese që trajtoi problematika të rëndësishme teorike dhe praktike në fushën e së drejtës së pronës. Tematikat përfshinë trashëgiminë ligjore dhe testamentare, mënyrat origjinale të fitimit të pronësisë, parashkrimin fitues, mjetet ligjore për mbrojtjen e së drejtës së pronës, si dhe procesin e njohjes dhe kompensimit të pronave të ish-pronarëve.

Trajnimet synuan analizimin e problematikave të hasura në praktikën gjyqësore dhe thellimin e njohurive mbi instrumentet ligjore për mbrojtjen e të drejtës së pronës dhe garancitë kushtetuese që e shoqërojnë atë.



**Foto. Trajnim, datë 19 tetor 2026**



**Foto. Trajnim, datë 22 tetor 2026**

**5. Mbrojtja e mjedisit dhe zbatimi i standardeve evropiane**

Në datat 26, 27 dhe 29 tetor 2026, në kuadër të modulit “Regjimi juridik i mbrojtjes së mjedisit”, u zhvillua një cikël trajnimesh mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe evropian për mbrojtjen e mjedisit dhe rolin e gjykatave në garantimin e zbatimit të tij.

Në fokus të aktiviteteve ishin regjimi juridik i lejeve mjedisore dhe monitorimi i zbatimit të tyre, praktika gjyqësore administrative dhe penale, e drejta për informim në çështjet mjedisore, mbrojtja kushtetuese e mjedisit, si dhe mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, u trajtuan çështje që lidhen me legjitimimin e individëve dhe grupeve të interesit, raportin ndërmjet përgjegjësisë penale dhe administrative dhe kufijtë e shqyrtimit gjyqësor.



**Foto. Trajnim, datë 26 tetor 2026**



**Foto. Trajnim, datë 29 tetor 2026**

Muaji tetor shënoi gjithashtu vijimin e përdorimit të platformës SMVSHM si një risi në administrimin e Programit të Formimit Vazhdues, duke mundësuar menaxhimin e aplikimeve dhe të pjesëmarrjes në aktivitetet e kalendarit trajnues për vitin akademik 2026–2027. Ky zhvillim përbën një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit dhe lehtësimit të proceseve administrative, në funksion të një organizimi më efikas dhe transparent të formimit vazhdues.

## Platforma digjitale dhe shërbimeve online

Faqja zyrtare e Shkollës u rindërtua tërësisht dhe u vu online më 12 tetor 2026. Faqja e vjetër dhe sistemi i saj i menaxhimit të përmbajtjes u zëvendësuan nga një faqe e re, më e shpejtë dhe më e sigurt, me një dizajn institucional të pastër, i cili funksionon njësoj në kompjuter dhe në telefon. E gjithë përmbajtja u transferua në sistemin e ri: faqet, lajmet dhe mijëra dokumente. Menuja dhe struktura u riorganizuan sipas mënyrës si funksionon Shkolla: Formimi Fillestar me vitet akademike, Formimi Vazhdues, Publikimet, Partnerët dhe Programi i Transparencës. Rreth 1.200 adresa të faqes së vjetër ridrejtohen automatikisht te faqet përkatëse të reja, që lidhjet ekzistuese të mos humbasin. Faqja është gati për motorët e kërkimit dhe për shpërndarje: ka hartë të faqes (sitemap), përmbledhje me foto kur ndahet në Facebook e LinkedIn, dhe Google Analytics. U ndërtuan gjithashtu faqe të reja: “Platformat Digjitale”, me udhëzime dhe demonstrim të kyçjes me Microsoft; “Të dhënat e hapura”, në formatin e kërkuar nga Komisioneri me licencën e ripërdorimit; dhe formulari i kontaktit.

Për redaktorët, sistemi i ri i menaxhimit hapet me llogarinë zyrtare Microsoft (@magjistratura.edu.al), pa fjalëkalime të veçanta. Çdo publikim shfaqet automatikisht në faqe brenda pak minutash. Sistemi kujdeset vetë për disa detaje: adresën e faqes, foton kryesore të lajmit nga galeria, dhe pastrimin e formatimit kur

teksti kopjohet nga Word. Brenda çdo artikulli ka edhe butona për ndarje të shpejtë në Facebook dhe LinkedIn. Dokumentet shfaqen me ikona sipas llojit dhe në rendin që vendos redaktori. PDF-të hapen në shfletues, ndërsa skedarët Word dhe Excel shkarkohen drejtpërdrejt. Faqja e vjetër dhe sistemi i vjetër mbeten të arkivuara dhe të aksesueshme vetëm nga rrjeti i Shkollës, ndërsa dokumentet e vjetra mbeten të disponueshme.

## Sektori i Studimeve dhe Publikimeve

*"Përmes botimeve juridike, doktrina jo vetëm interpreton ligjin, por kontribuon në evolimin e tij"*

Gjatë muajit shtator 2026 doli libri "Drejtësia jote Nuk është Drejtësia ime", përkthim i realizuar nga Z. Zamir Poda – ish anëtar i Gjykatës së lartë dhe z. Ilir Panda – Kryetar i Gjykatës së Lartë, autorët e librit, Pierkamilo Davigo (Piercamillo Davigo) dhe Gerardo Kolombo (Gherardo Colombo), janë dy ndër magjistratët e shquar që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në drejtësinë italiane me hetimet dhe gjykimet e tyre ndër vite, ku mbi të gjitha kulmon procesi "Duart e Pastra", nisur në vitin 1992 në Milano.




Gjate kësaj periudhe Bordi i Redaktoreve miratoi dhe planin e botimeve për vitet 2026-2027:

### Plani i botimeve për vitet 2026-2027

| Nr. | Titujt e botimeve | Autorët |
|---|---|---|
| 1 | Revista nr. 2,3 viti 2024 | |
| 2 | Revista nr. 1,2,3 viti 2025 | |
| 3 | Revista nr. 1,2,3 viti 2026 | |
| 4 | Magjistrati nr. 18.19 | |
| 5 | Komentar mbi "Standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së prokurorit" | Arben Isaraj |
| 6 | Manual për mentorimin në praktikën paraprofesionale dhe profesionale | Grup autoresh |
| 7 | Drejtësia jote *nuk është* drejtësia ime | Perkthim: Ilir Panda & Zamir Poda |
| 8 | Traktati i të drejtës civile, me autor Prof. CESARE MASSIMO BIANCA, | Përkthim Arben Vani |
| 9 | Drejtësia dhe media | Arben Rakipi, Zylyftar Bregu |
| 10 | Komventen e Koferences se Hages per te drejten nderkombetare private (HCCH) 1980 mbi aspektet civile te rrembimit nderkombetar te femijeve. | Prof. dr. Arta Mandro & Dr. Aida Bushati |

## Aktivitete të Shkollës

Në kuadër të bashkëpunimit të Shkollës së Magjistraturës me Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi (AFMM), e cila organizon Festivalin Ndërkombëtar te Filmit për të Drejtat e Njeriut IHRFFA në Shqipëri, u realizua datën 17 shtator 2026 në sallën e amfiteatrit të godinës Poli i Drejtësisë shfaqja e filmit dokumentar "Lufta, Kërkimi i Paqes, Sundimi i Ligjit dhe Përkujtimi i Viktimave".

Filmi u pasohet nga një bashkëbisedim dhe pyetje/përgjigje me të ftuarit në shfaqjen e filmit. Filmi i përzgjedhur për tu shfaqur trajton tematika që lidhen me sfidat bashkëkohore me të cilat përballen institucionet e drejtësisë dhe me gjerë në kohë ndryshimesh.

Në aktivitet morën pjesë kandidatët për magjistratë, pedagogë, dhe përfaqësues të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut IHRFFA në Shqipëri.




Me ftesë të Rrjetit Evropian për Trajnime Gjyqësore, Shkolla e Magjistraturës, e përfaqësuar nga znj. Borana Mustafaraj, Drejtore e Formimit Profesional, mori pjesë në aktivitetin "Trainer Lab: Sharing the Best Practices in Judicial Training". Aktiviteti u zhvillua në qytetin e Lisbonës gjatë 1-2 Tetorit 2026.

Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor, me këtë aktivitet, prezantoi Laboratorin e tij të parë të Trajnerëve, një aktivitet i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave ndërmjet kolegësh, që bashkon institucionet e trajnimit gjyqësor nga e gjithë Evropa rreth qëllimit të

Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor, me këtë aktivitet, prezantoi Laboratorin e tij të parë të Trajnerëve, një aktivitet i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave ndërmjet kolegësh, që bashkon institucionet e trajnimit gjyqësor nga e gjithë Evropa rreth qëllimit të përbashkët dhe nevojës për sjelljen e risive në metodat e trajnimit gjyqësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve të institucioneve trajnuese.

I organizuar nga Grupi i Punës për Metodat e Trajnimit Gjyqësor i Rrjetit, aktiviteti iu përgjigj një observimi të thjeshtë: në vitet e fundit, ndryshimi teknologjik, dixhitalizimi i trajnimit dhe evolucioni i dizajnit të të mësuarit i kanë hapur derën praktikave dhe iniciativave të reja, të cilat meritojnë të njihen më mirë, të diskutohen dhe, nëse janë të rëndësishme, të shërbejnë si frymëzim për të tjerët. Shkolla prezantoi zhvillimet e viteve të fundit në procesin dhe metodologjinë e trajnimit fillestar dhe vazhdues dhe sfidat e të ardhmes, veçanërisht përgatitja e magjistratëve shqiptarë për të drejtën e BE.



Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë së Kosovës dhe Shkollës së Magjistraturës, në datën 23 Tetor 2026, në Prishtinë, u realizua aktiviteti trajnues me tematikë *"Hetimi dhe Gjykimi i veprave penale në fushën e Prokurimit Publik". Ky aktivitet realizohet* me pjesëmarrjen e magjistratëve nga Kosova dhe magjistratëve nga Shqipëria.

Aktivitetin trajnues e përshëndetën Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Z. Enver Fejzullahu, dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, Z. Arben Rakipi. Njëkohësisht, aktiviteti u përshëndet edhe nga ekspertët e aktivitetit, të cilët ishin Z. Shqipdon Fazliu, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në Kosovë, Znj. Reida Kashta, Drejtore e Agjencisë së Prokurimit Publik në Shqipëri, si dhe Z. Ylli Pjetërnikaj, Prokuror dhe Ekspert i Shkollës së Magjistraturës.

Në aktivitetin trajnues u trajtuan temat subjekt i seminarit të angazhuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Shkolla e Magjistraturës si:

- Kualifikimi ligjor i veprave penale në prokurimin publik: favorizimi, korrupsioni dhe shpërdorimi i detyrës

- Kufijtë dhe konkurrimi i figurave penale. Metodologjia bashkëkohore e hetimit të shkeljes së barazisë në tendera, nga të dhënat elektronike tek prova penale, problematika procedurale dhe penale.
- Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i shkeljeve në prokurim: integriteti, treguesit e rrezikut (red flags) dhe hetimi administrativ në prokurimin publik.
- Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurimin publik.

Aktiviteti trajtoi gjithashtu praktikën gjyqësore krahasuese Kosovë-Shqipëri: analizë çështjesh dhe standardet e provës në veprat penale të prokurimit.



Ju ftojmë të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të Me respekt,

**Shkolla e Magjistraturës**

www.magjistratura.edu.al

**E-mail**: info@magjistratura.edu.al

| Nr. | FUSHA | EMRI I MODULIT / TEMËS SË TRAJNIMIT | PANELISTËT (Ekspertë / Lehtësues) | |
|---|---|---|---|---|
| | | nëntor 2026 | | |
| 1. | ETI | **MODUL g. 1 ÇËSHTJE TË ETIKËS, INTEGRITETIT, DEONTOLOGJISË DHE KOMUNIKIMIT**<br>Tema 2: Inteligjenca emocionale dhe stresi. | Ekspertë: Arben Isaraj<br>Arta Mandro<br>Lehtësues: Marta Bej<br>Gentiana Xhelili | **2 nëntor 2026** |
| 2. | ADM BE | **Konkurrenca**<br>Zgjidhja e konflikteve midis palëve private në të drejtën e konkurrencës - Neni 101 të TFBE-së – Pasojat në të drejtën civile të shkeljeve në përgjithësi; dëmshpërblimi si pasoja juridike më e rëndësishme; origjina, rastet dhe parakushtet e përgjegjësisë sipas Direktivës 2014/104/BE mbi disa rregulla që rregullojnë paditë për dëmshpërblim sipas legjislacionit kombëtar për shkeljet e dispozitave të së drejtës së konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian; çështjet kryesore problematike; jurisprudenca e fundit e GJED-së; raste studimore. | Ekspertë: Denar Biba<br>Bashkëpunim me KE | **3 nëntor 2026** |
| 3. | ETI | **MODUL g. 1 ÇËSHTJE TË ETIKËS, INTEGRITETIT, DEONTOLOGJISË DHE KOMUNIKIMIT**<br>Tema 3: Komunikimi institucional i magjistratit. | Ekspertë: Ledina Riza<br>Evis Alimehmeti<br>Lehtësues: Armand Bora | **3 nëntor 2026** |
| 4. | ETI KUS | **MODUL g. 1 ÇËSHTJE TË ETIKËS, INTEGRITETIT, DEONTOLOGJISË DHE KOMUNIKIMIT**<br>Tema 4: Paanshmëria si standard kushtetues dhe ligjor. | Ekspertë:<br>Arben Isaraj<br>Emona Muçi<br>Lehtësues: Emirjana Dimo | **4 nëntor 2026** |
| 5. | ETI | **MODUL g. 1 ÇËSHTJE TË ETIKËS, INTEGRITETIT, DEONTOLOGJISË DHE KOMUNIKIMIT**<br>Tema 5: Integriteti si harmonizim i vlerave etike. | Ekspertë:<br>Evis Alimehmeti<br>Perikli Zaharia<br>Lehtësues: Elena Pelushi | **5 nëntor 2026** |
| 6. | CIV BE | **MODUL b.4 "MARRËDHËNIET E PUNËS"**<br>Dhuna, ngacmimi dhe ngacmimi seksual në marrëdhëniet e punës: kuadri ligjor shqiptar, standardet e ONP-së dhe të Bashkimit Evropian. | Ekspertë: Arta Mandro<br>Albana Shtylla<br>Lehtësues: Rudi Laze | **6 nëntor 2026** |
| 7. | CIV | **MODUL b.3 "EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM"**<br>Titujt ekzekutivë, llojet e akteve të parashikuara nga ligji, praktika gjyqësore. | Ekspertë: Vagjel Kosta<br>Elona Toro<br>Lehtësues: Ejona Lazellari | **9 nëntor 2026** |
| 8. | ADM PEN | Trajnimi i Specializuar Multidisiplinar mbi Çështjet Mjedisore me Partnerët e Zinxhirit të Drejtësisë Penale. | Ekspertë: Elvana Çiçolli<br>Bashkëpunim me Expertise France | **10 nëntor 2026** |

| Nr. | FUSHA | EMRI I MODULIT / TEMËS SË TRAJNIMIT | PANELISTËT (Ekspertë / Lehtësues) | |
|---|---|---|---|---|
| nëntor 2026 | | | | |
| 9. | CIV | **MODUL b.3 "EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM"**<br>Përmbajtja e urdhrit të ekzekutimit. | Ekspertë: Dashamir Kore<br>Altin Shkurti<br>Lehtësues: Anjeza Buzo | **10 nëntor 2026** |
| 10. | PEN KUS | **MODUL a.1 "I PANDEHURI NË PROCESIN PENAL"**<br>Akti i njoftimit të akuzës, karakteristikat, garancitë kushtetuese dhe ligjore: veprim hetimor/procedural. Pavlefshmëria e aktit të njoftimit të akuzës, pasojat e pavlefshmërisë. Ndryshimi, plotësimi dhe saktësimi i akuzës. Kuptimi dhe zbatimi i tyre në praktikë. Rimarrja e cilësisë së të pandehurit pas prishjes së vendimit dhe efektet ligjore. | Ekspertë:<br>Klodian Kurushi<br>Arqilea Koça<br>Lehtësues: Lorena Çabej | **11 nëntor 2026** |
| 11. | PEN KUS | **MODUL a.1 "I PANDEHURI NË PROCESIN PENAL"**<br>Mbrojtja e detyrueshme e të pandehurit, si standard kushtetues dhe konventor: kuptimi dhe zbatimi në praktikë i nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale. Rastet e mbrojtjes së detyrueshme, pavarësisht vullnetit të të pandehurit lidhur me caktimin e një mbrojtësi. Shpërblimi i mbrojtësit të caktuar në rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Rastet e zëvendësimit të mbrojtësit dhe pasojat ligjore. Mungesa e të pandehurit në proces dhe pasojat e saj. | Ekspertë:<br>Arqilea Koça<br>Sotir Kllapi<br>Lehtësues: Gentian Jahjolli | **12 nëntor 2026** |
| 12. | CIV | **MODUL b.3 "EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM"**<br>Mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv. | Ekspertë:<br>Enton Dhimitri<br>Ervin Pollozhani<br>Lehtësues: Olti Skrame | **13 nëntor 2026** |
| 13. | KUS | **MODUL d.1 "DISKRIMINIMI**<br>Standardet materiale dhe procedurale të mbrojtjes nga diskriminimi: kuadri kushtetues dhe ligjor. Barra e provës dhe roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Identifikimi i diskriminimit dhe elementët përbërës të tij. | Ekspertë: Arta Vorpsi<br>Genta Tafa (Bungo)<br>Lehtësues: Entela Gjoni | **16 nëntor 2026** |

| Nr. | FUSHA | | EMRI I MODULIT / TEMËS SË TRAJNIMIT | PANELISTËT (Ekspertë / Lehtësues) | |
|---|---|---|---|---|---|
| nëntor 2026 | | | | | |
| 14. | PEN | KUS | **MODUL a.1 "I PANDEHURI NË PROCESIN PENAL"**<br>I bashkëpandehuri dhe i pandehuri në një procedim të lidhur. Të drejtat dhe garancitë procedurale që ofron ligji, rregullat procedurale të pyetjes së tyre. Praktika e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ. Bashkëpunëtori i drejtësisë. Marrëveshja e bashkëpunimit, kushtet dhe zbatueshmëria e saj. Aspektet ligjore dhe procedurale të statusit të "bashkëpunëtorit të drejtësisë". | Ekspertë:<br>Klodian Kurushi<br>Albert Meça<br><br>Lehtësues: Odeta Todorushi | **17 nëntor 2026** |
| 15. | PEN | KUS | **MODUL a.1 "I PANDEHURI NË PROCESIN PENAL"**<br>Garantimi i balancës ndërmjet interesit të hetimit penal dhe respektimit të të drejtave themelore të individit, veçanërisht sa i takon fshehtësisë së korrespondencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. | Ekspertë: Florjan Kalaja<br>Nertina Kosova<br>Lehtësues: Olgert Rumnici | **18 nëntor 2026** |
| 16. | CIV | BE | **MODUL b.7 "KONTRATAT KONSUMATORE, PAVLEFSHMËRITË"**<br>Mosmarrëveshjet në të drejtën e konsumatorit që prekin interesin individual të konsumatorit. Mosmarrëveshjet në të drejtën e konsumatorit që prekin interesin kolektiv të konsumatorit. Praktika administrative dhe gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të së drejtës së konsumatorit në Shqipëri. | Ekspertë:<br>Ersida Teliti<br>Bezart Kaçkini<br>Lehtësues:<br>Klotilda Neziri (kryetare e Komisionit të Konsumatorit) | **19 nëntor 2026** |
| 17. | KUS | | **MODUL d.1 "DISKRIMINIMI**<br>Arsyetimi gjyqësor në çështjet e diskriminimit: struktura e vendimit, diskriminimi me bazë gjinore dhe racore, riviktimizimi dhe mbrojtja efektive. Standardet kushtetuese dhe ligjore. | Ekspertë:<br>Fiona Papajorgji<br>Genta Tafa (Bungo)<br>Aurela Anastas<br>Lehtësues: Maela Alicanaj<br>Bashkëpunim me QNL | **20 nëntor 2026** |

| Nr. | FUSHA | | EMRI I MODULIT / TEMËS SË TRAJNIMIT | PANELISTËT (Ekspertë / Lehtësues) | |
|---|---|---|---|---|---|
| nëntor 2026 | | | | | |
| 18. | CIV | BE | **MODUL b.7 "KONTRATAT KONSUMATORE, PAVLEFSHMËRITË"**<br>Kushtet e padrejta në kontratat konsumatore në kuadrin e legjislacionit të BE-së dhe legjislacionit material të R.Sh-së. Detektimi automatik i kushteve abuzive në kontratat me konsumatorët në vendimet kryesore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Çmimi kryesisht i klauzolave abuzive në kontratat me konsumatorët në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë. Efektet e proceseve të ndryshme të gjykimit të konsumatorit në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë. Integrimi i kontratës që përmban klauzolën abuzive në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë. | Ekspertë:<br>Gentian Medja<br>Elda Vrioni<br>Lehtësues:<br>Ersida Teliti<br>(specialist fushe) | **24 nëntor 2026** |
| 19. | ADM | PEN | **MODUL c.4 "PROKURIMET PUBLIKE"**<br>Hetimi i skemave komplekse të korrupsionit në prokurimet publike: nga shkelja procedurale te prova penale. Përgjegjësia penale e personave juridikë në prokurimet publike: kriteret e atribuimit të përgjegjësisë. | Ekspertë:<br>Reida Kashta<br>Flojera Davidhi<br>Lehtësues: Florian Boriçi<br>Bashkëpunim me OSBE | **25 nëntor 2026** |
| 20. | PEN | KUS | **Trajnim 1 ditor**<br>Vendimmarrja lidhur me mos fillimin e procedimit penal. Efektet e mosrespektimit të afatit ligjor 15 ditor. Momenti i fillimit të ecjes së afatit në rastet e kallëzimeve të paraqitura në prokurori që nuk kanë kompetencë për shqyrtimin e kallëzimit. Garancitë për një proces të rregullt ligjor. | Ekspertë:<br>Ardit Mustafaj<br>Albert Kuliçi<br>Lehtësues: Eni Çulli | **26 nëntor 2026** |
| 21. | ADM | | **MODUL c.4 "PROKURIMET PUBLIKE"**<br>Provat elektronike due analiza e të dhënave në hetimin e prokurimeve publike. | Ekspertë:<br>Bledar Maksuti<br>Arian Muçaj<br>Lehtësues: Alma Felaj | **27 nëntor 2026** |